



REPUBLIKA E KOSOVËS
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



PSH. nr. 467/18

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje z. Goran Milenković - Kryetar, z. Nuhi Paçarizi - Referues, z. Blerim Dina – Anëtar, si dhe duke u bazuar në nenin 30 të Rregullores së Punës së OSHP-së nr. 01/2017 të dt: 20.03.2017, pas shqyrtimit të kërkesës së datës 24 Shtator 2018, të parashtruar nga OE “Doni Term”- Drenas për tërheqje të ankesës së dt: 07.09.2018 lidhur me aktivitetin e prokurimit "Shpimi i puseve dhe ndërtimi i sistemit të ujitjes për gjelbërim Lot I dhe II" me nr. të Prokurimit: 616/18/4902/521 të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues “KK-Prishtinë” me datën 25.09.2018, mori këtë:

V E N D I M

I. APROVOHET, kërkesa e datës 24 Shtator 2018, e operatorit ekonomik “Doni Term”- Drenas për tërheqjen e ankesës me nr. 467/18, të datës 07.09.2018, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Shpimi i puseve dhe ndërtimi i sistemit të ujitjes për gjelbërim Lot I dhe II" me nr. të Prokurimit: 616/18/4902/521 të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues “KK-Prishtinë”

II. NDËRPREHET, procedura e shqyrtimit të ankesës së operatorit ekonomik “Doni Term”- Drenas me nr. 467/18 të datës 07.09.2018, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Shpimi i puseve dhe ndërtimi i sistemit të ujitjes për gjelbërim Lot I dhe II" me nr. të Prokurimit: 616/18/4902/521 e iniciuar nga Autoriteti Kontraktues “KK-Prishtinë”

III. I LEJOHET, autoritetit kontraktues, që të vazhdoj më tutje me këtë aktivitet të prokurimit përkitazi me këtë ankesë, ndërsa nëse ka ankesë tjetër, ajo vazhdon të shqyrtohet në mënyrë të rregullt dhe aktiviteti i prokurimit mbetet i pezulluar ashtu siç parashihet në nenin 112 paragrafi 1 të LPP-së.

IV. Meqenëse aprovohet tërheqja e OE ankues nga ankesa dhe pretendimet ankimore, si dhe duke u bazuar në nenin 30.2 të Rregullores së punës së OSHP-së, këtij OE i kthehet sigurimi i ankesës në vlerën e deponuar me rastin e parashtrimin të ankesës.

V. Urdhërohet, OE ankues që konform nenit 33 pika 6 e Rregullores të Punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën i bëhet konfiskimi i depozitës, dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

ARSYETIM

Operatori Ekonomik “Doni Term”- Drenas , ka parashtruar ankesë në OSHP me datën 07.09.2018, me nr. 467 /18, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Shpimi i puseve dhe ndërtimi i sistemit të ujitjes për gjelbërim Lot I dhe II” me nr. të Prokurimit: 616/18/4902/521 të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues “KK-Prishtinë” duke pretenduar se AK-ja, ka bërë shkelje të nenit: 1,6,7,59,60,61,72, të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092.

Me datën 07.09.2018, është njoftuar autoriteti kontraktues nga OSHP-ja për pranimin e ankesës së lartpërmendur lidhur me aktivitetin e prokurimit "Ndërtimi i 25 puseve, kryerja e testeve dhe analizave të pompimit në pellgun e lumit Drini i Bardhë” me nr. të Prokurimit: Kep-002-2018.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 13.09.2018 ka autorizuar ekspertin shqyrtues profesional të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti Shqyrtues profesional në raportin e dt: 24.09.2018, lidhur me pretendimin ankimor të OE ankues: “Doni Term”- Drenas në finalizim të analizimit dhe shqyrtimit të këtij aktiviteti të prokurimit, konstaton si në vijim:

Operatori ekonomik ankues NPSH “DONI TERM”, pretendon se dy Operatoret tjerë të cilët kanë konkurruar në këtë aktivitet të prokurimit nuk e kanë vendosur çmimin e tenderit por piket e grumbulluara në bazë të para masës , e ku në formularin e tenderit thotë të vendoset çmimi në euro e jo pikët.

Eksperti shqyrtues sqaron se është e vërtetë se OE i rekomanduar për dhënie të kontratës “NITI-N SHPK & CAJA COMPANY” dhe OE “VPD DRILL SHPK & BURIMI COM SHPK”, në formularin e tenderit e kanë të shënuar çmimin total të shënuar me pik, mirëpo në para masa i kanë të shënuar çmimet për njësi si dhe çmimet totale të shënuar me pikë.

Çmimi i OE të rekomanduar për dhënie të kontratës “NITI-N SHPK & CAJA COMPANY”, në para masa është si në vijim:

Lot I me çmim prej: 1,144.50€ , dhe çmim total i peshuar 21.20.

Lot II me çmim prej: 132.50 € , dhe çmim total i peshuar 14.66.

Po ashtu duke u bazuar në nenin 56.11 të RrUOPP, ku thuhet: “Kurdo që AK-së, nuk din sasi të indikativë kontratat me çmime për njësi, autoriteti kontraktues duhet të përcaktoj peshën në bazë të rëndësisë së secilës “kategori të shërbimeve” ose secilit “artikull” në mënyrë që AK-së të përcaktoj se cila është oferta me çmimin

ma të ulët. Në këtë raste nuk vlen pragu apo tavani plus/minus (30%), si për shembull mirëmbajtja e veturave, mirëmbajtja e gjeneratorëve etj. Në këtë raste në hapjes publike të ofertës lexohet çmimi total i poentuar (peshuar) i cili shërben vetëm për qëllim të vlerësimit të ofertave, ndërsa kontrata lidhet me çmim për njësi. Shuma e sigurimit të ekzekutimit të kontratës në këtë rast duhet të përcaktohet si shumë fikse për qëllim të raportimit në KRPP, shënohet vlera e parashikuar e kontratës”.

Pas analizimi të ofertave të OE pjesëmarrës në këtë aktivitet të prokurimi, dhe duke u bazuar në nenin 56.11 të RrUOPP, operatori ekonomik i rekomanduar për dhëni të kontratës “NITI-N SHPK & CAJA COMPANY”, gjatë plotësimit të dosjes së tenderit ka vepruar drejtë.

Po ashtu konform nenit 59. 4 të LPP-së, pretendimin e OE ankues në lidhje me formularin e tenderit mund të konsiderojmë si devijim të vogël, Citat: “Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit. Pavarësisht nga e mëparshmeja, autoriteti kontraktues mund të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm nëse: (i) përmban vetëm gabime ose paqartësi të cilat mund të korrigjohen pa ndryshuar kushtin material apo aspektin e tenderit në fjalë, ose (ii) përmban vetëm devijime të vogla që nuk mund të shkaktojnë ndryshime materiale ose devijime nga karakteristikat, kushtet, dhe kërkesat e tjera të parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit; me kusht që çfarëdo devijimi i tillë të kualifikohet, aq sa është e mundshme, dhe të merret parasysh gjatë vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve”.

Operatori ekonomik ankues NPSH “DONI TERM”, pretendon se Formulari dhe paramasa e konzerciumit “Niti & Caja Company”, nuk është nënshkruar dhe vulosur nga të dy anëtarët e konsorciumit.

Eksperti shqyrtues sqaron se konsorciumi “NITI-N SHPK & CAJA COMPANY”, në dosjen e tenderit e ka ofruar Marrëveshjen e bashkëpunimit, si dhe katër (4) deklaratat ashtu siç parashihet në nenin 71 të LPP-së, ku në njërin prej deklaratave thuhet: “Palët janë pajtuar që bartës të jetë partneri “NITI-N” SHPK, i cili autorizohet që të firmosë të gjitha dokumentet në lidhje me tenderin dhe kontratë”.

Andaj formulari i tenderit dhe para masa është nënshkruar nga lideri i konsorciumit, ashtu siç parashihet në deklaratë, dhe këtu nuk kemi as një shkelje.

Sa i përket pretendimit të OE ankues NPSH “DONI TERM”, ku pretendon se në shumicën e pozicioneve OE i rekomanduar për dhënie të kontratës ka ofruar çmime jo normalisht të ulëta.

Eksperti shqyrtues sqaron se për çmimet jo normalisht të ultë, është përgjegjësi e AK-së, konkretisht këtë çështje e rregullon neni 61.1 i LPP-së, Citat: “Nëse një operator ekonomik e dorëzon një tender që është ose duket të jetë jo-normalisht i ulët, autoriteti kontraktues do të dërgojë një kërkesë me shkrim tenderuesit ku kërkohet nga tenderuesi që të dorëzojë me shkrim : (i) një ndarje të elementeve përbërëse të tenderit dhe (ii) shpjegime në lidhje me bazën e tenderit, sipas paragrafin 2. të këtij neni”.

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesën e OE ankues ta refuzoj si të pa bazuar (për arsyen që u cekura më lartë tek përgjigjet), të aprovohet njoftimi për dhënie të kontratës.

Përfaqësuesi i OE ankues "Doni Term"- Drenas me datën 24.09.2018, ka deponuar në OSHP, kërkesën për tërheqjen e ankesës, lidhur me tenderin me titull "Shpimi i puseve dhe ndërtimi i sistemit të ujitjes për gjelbërim Lot I dhe II" me nr. të Prokurimit: 616/18/4902/521 të zhvilluar nga Autoriteti Kontraktues "KK-Prishtinë" me arsyen se jemi te ngarkuar me punë dhe projekte te tjera dhe nuk kemi interes Juridik te vazhdojmë me tutje me këtë aktivitet te prokurimit.

Paneli shqyrtues, pasi shqyrtoj kërkesën e operatorit ekonomik ankues, vendosi si në diapozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative për kompensim dëmi ne afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit .



Kryesuesi i Panelit Shqyrtues
z. Goran Milenković

Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK – "KK-Prishtinë"

1x1 OE - "Doni Term"- Drenas

1x1 Arkivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në web- faqe të OSHP-së.